

Shoqata „Greikoci“

Raport vjetor 2020

Ossingen ZH (Zvicër), 31 dhjetor 2020

Hyrje

Të nderuar anëtarë dhe miq, viti 2020 për të gjithë ne do të mbetet gjatë në kujtesë, ngase u ballafaquam me një situatë të jashtëzakonshme me pandeminë COVID-19, e cila, pothuajse, nuk la familje pa e prekur. Urojmë që në vitin 2021 njerëzimi do të arrijë që ta fitojë betejën kundër këtij virusi dhe secili prej nesh të jetojë shëndoshë dhe në kushte normale.

Njëkohësisht duam të theksojmë se më 17 maj 2020, shoqata “Greikoci” shënoi 5 vjetorin e themelimit. Për shkak të pandemisë një organizim festiv kushtuar kësaj date nuk ishte i mundur. Ne si kryesi e shoqatës “Greikoci” falënderojmë të gjithë anëtarët, kontribuuesit dhe sponsorët për mbështetjen e tyre morale dhe financiare për këto 5 vitet e fundit.

Gjithashtu, mbledhja e rregullt e anëtarësisë, e cila ishte planifikuar që të mbahet më 29 mars 2020, u shtye për 9 shtator 2020 për shkak të pandemisë. Në këtë mbledhje, shoqata “Greikoci” raportoi për aktivitetet e vitit 2019, si dhe zgjodhi kryesinë e re (10 anëtarëshe) për katër vitet e ardhshme, e cila u zotua se puna dhe aktiviteti do të vazhdojnë.

Kryesia e re e shoqatës “Greikoci” uron dhe beson se në katër vitet e ardhshme do të arrijë që të dorëzojë detyrimet e marra rreth mirëmbajtjes së fshatit Greikoc, strukturave kompetente të fshatit Greikoc, por dhe komunës së Suharekës. Po ashtu, beson që efektin sensibilizues (pas një funksionalizimi 5 -vjeçar në lëmin e mirëmbajtjes) e ka arritur dhe është e logjikshme që përgjegjësinë për ta mbajtur në jetë këtë standard, duhet ta dorëzojë te njerëzit që banojnë në fshat.

Në vazhdimësi ua prezantojmë projektet e Shoqatës, të cilat karakterizuan aktivitetet e shoqatës “Greikoci” për vitin 2020.

Shportat e bërllokut (mars 2020)

Gjatë muajit mars të vitit 2020, shoqata “Greikoci” vendosi që të instalojë 30 shporta të bërllokut në gjithë teritorin e fshatit Greikoc.



Ndihma për ambulancën e fshatit Greikoc (prill 2020)

Me moton: „Së bashku kundër COVID-19“, shoqata „Greikoci“ dhuroi material mbrojtës për ambulancën e fshatit Greikoc, me rastin e gjendjes aktuale pandemike, që po zotëron në mbarë botën, në vlerë prej 373.50 eurosh.

Falënderojmë njëkohësisht pronarin e “M&A Market”, Veli Selimaj për bashkëngjitjen në këtë aksion me:

- 3 pako dorëza
- 2 dezinfektues
- 25 maska
- 1 aparat për shampun



Pako ushqimore për 20 familje (maj 2020)

Situata me COVID-19, që po sundon në gjithë botën, por edhe në muajin e shenjtë të Ramazanit, shtyu shoqatën “Greikoci” që të shpërndajë pako ushqimore për 20 familje të nevojshme në Greikoc.



Donacion klubit të futbollit KF „Greikoci“ (nëntor 2020)

Shoqata „Greikoci“ i doli në mbështetje KF „Greikoci“ me një donacion prej 400 eurosh. Urojmë që futbollistët e së nesërme të bëhen krenaria e fshatit tonë.



Ndërresa për KF “Greikoci” (dhjetor 2020)

Me përfundimin e vitit 2020, shoqata “Greikoci” vendosi që t’i dalë në ndihmë KF “Greikoci”, duke ju dhuruar ndërresa sportive lojtarëve të rinj.

Mirëmbajtja e fshatit Greikoc (janar - dhjetor 2020)

Ju rikujtojmë se në mirëmbajtjen e fshatit Greikoc janë aktualisht të angazhuar: Rexhep Lushaj dhe Haxhi Haxhaj, ku falë punës së tyre fshati Greikoc gëzon një nivel më të lartë të pastërtisë, se sa vendbanimet e tjera të komunës së Suharekës.



Falënderim për anëtarët (dhjetor 2020)

Në shenjë falënderimi, shoqata “Greikoci” vendosi që t’ua shpërndajë të gjithë anëtarëve, kontribuuesve dhe sponsorëve nga një mbajtëse të çelësave me logon e Shoqatës, në njërën faqe, kurse në faqen tjetër me foton e fshatit Greikoc.



Rreth shoqatës „Greikoci“:

Themelimi: 17 maj 2015
Selia: Ossingen ZH – Zvicër
Numri i anëtarëve: mbi 210
Kryetar: Regjep Neziraj (+41 79 489 49 92)
Webfaqja: www.greikoci.ch
Kontakt: shoqata_greikoci@gmx.ch
Facebook: Shoqata Greikoci

Synimet për vitin 2021

Për vitin 2021, kryesia e Shoqatës ka vendosur që fokus kryesor të ketë mirëmbajtjen e ambientit të fshatit Greikoc dhe krijimin të një zone rekreative, ku banorët e Greikocit do të kenë hapësirë për të ndërmarrë aktivitete sportive. Gjithashtu, do të përkrahë në vazhdimësi projekte, ku mbështetjen të rinjtë e fshatit Greikoc. Projektet konkrete do të pasojnë gjatë pranverës së vitit 2021.